



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	29-05-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPR/MSHOK/4509/2023			119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.638/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.638/2023 të datës 14.04.2023, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati

kundër Vendimit KD.nr.03/2023 i datës 13.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.638/2023 e datës 14.04.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me numër KD.nr.4/22 i datës 28.09.2022 dhe Vendimi me numër KD.nr.03/2023 i datës 13.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë.

III. Obligohet Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës sipas Aktit të emërimit të datës 07.08.2012.

IV. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që ankuesit t'i bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave të ndaluara në emër të vendimeve të përcaktuara si në pikën II të diapozitiv.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.



## A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datën 12.04.2023 nëpërmjet poste ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është pranuar me datë 14.04.2023 me numër të protokollit 3561/2023 dhe regjistruar nën shenjën A.nr.638/2023, kundër Vendimit KD.Nr.03/2022 të datës 13.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit material, shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Drejtësisë, ndërsa Këshilli me datë 16.05.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 3561/2023 të parashtruar nga ankuesi me datë 14.04.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.Nr.03/2022 të datës 13.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin e Këshillit A.nr.1233/2023 të datës 20.02.2023; Fletë pagesë e postës e datës 19.12.2022; Shkresën "fjala e Kryeinspektorit kundër Konstatimeve të Komisionit për ri inspektim për rastin postar me shifër R2753482 i datës 12.04.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.04.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 16.05.2023; Shkresën përcjellëse me shifër 01-826/9 të datës 27.02.2023 përcjellë nga A.N për A.Sh; E-mailin e datës 28.02.2023 dërguar nga A.Sh për V.I.G dhe të tjerët me korrespondencën e bashkangjitur prej një (1) faqe; E-mailin e datës 10.03.2023 dërguar nga A.Sh për A.N me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 10.03.2023 dërguar nga A.Sh për A. N; Raporti i datës 21.11.2016 me numër:01-4435 përgatitur nga ankuesi i titulluar "Inspektimi i rastit të vdekjes së të burgosurit Raporti i datës 14.11.2016 me numër 3 (në anën e majtë, pjesa lartë- shenjë e pa identifikueshme nëse është protokolluar) përgatitur nga ankuesi i titulluar "Inspektimi i rastit të vdekjes së të burgosurit Procesverbalin e datës 10.03.2023 të seancës së Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 11.10.2023 dërguar nga M.B për A.N me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e datës 11.10.2023 dërguar nga A.N për M.B me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e datës 11.10.2023 dërguar nga A.N për M.B me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 12.10.2023 dërguar nga M.B për A.N me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e datës 10.10.2023 dërguar nga A.N për Z.S; E-mailin e datës 10.10.2023 dërguar nga A.N për J.K; Shkresën e titulluar "INFORMATË" me shifër:136/16 të datës 11.11.2016; Kopjen e librit të pranimi nga posta i datës 13.03.2023; Vendimin me numër KD.nr.03/2022 të datës 30.06.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Konkursin e datës 11.05.2011; Akt emërimit e ankuesit të datës 07.08.2012; Vendimin Nr.23/2023 të datës 24.02.2023 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Ankesën me numër të protokollit 8259/2022 të parashtruar nga ankuesi me datë 21.12.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 17.10.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit; Vendimin me numër KD.nr.07/2022 të datës 18.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin e datës 18.10.2022 të Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin me numër KD.nr.4/2022 të datës 28.09.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë;



Vërtetimin e datës 12.12.2022 të lëshuara nga Policia e Kosovës; Çertifikatën e datës 30.11.2022 lëshuar nga Gjykatat Themelore në Ferizaj-Dega Ferizaj; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.12.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.01.2023; Konkursin e datës 11.05.2011; Akt emërimit e ankuesit të datës 07.08.2012; Kërkesën e datës 19.09.2022 për iniciimin e procedurës disiplinore dërguar nga A.A për R.O; E-mailin e datës 19.09.2022 dërguar nga L.B për A.N; Raportin zyrtar me numër:01-826 të datës 29.08.2022 të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin Nr.32/2022 i datës 03.03.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për themelimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin ZSP-Nr.101/22 i datës 07.09.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për plotësimi ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin ZSP-Nr.109/22 i datës 23.09.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për plotësimi ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Procesverbalin e seancës disiplinore të mbajtur nga Komisioni Disiplinor me datë 13.10.2022 në ora 09:00; ; Procesverbalin e seancës disiplinore të mbajtur nga Komisioni Disiplinor me datë 13.10.2022 në ora 14:00; Shkresën me numër refrenece:136/16 e datës 11.11.2016 e titulluar "Informatë"; Procesverbalin e seancës disiplinore të mbajtur nga Komisioni Disiplinor me datë 13.10.2022 në ora 15:00; Procesverbalin e seancës disiplinore të mbajtur nga Komisioni Disiplinor me datë 13.10.2022 në ora 14:30; E-mailin e datës 18.01.2023 dërguar nga R.O për A.N; E-mailin e datës 11.10.2022 dërguar nga G.N për R.O; E-mailin e datës 10.10.2022 dërguar nga R.O për G.N.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *bazuar*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shkresat e administruara të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 07.08.2012 mban pozitën e punës "Kryeinspektor i Inspektoratit" në kuadër të Divizionit: Inspektorati për Inspektimin e Punës në SHKK pranë Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa ndaj të njëjtit Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë me datë 19.09.2022 ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore për shkak të shkeljeve disiplinore të gjetura në Raportin Zyrtar të datës 29.08.2022 të përgatitur nga inspektorët- M.B, Z.S dhe J.K në kuadër të Inspektoratit për Inspektimin e Punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës, raport i cili ishte përgatitur me kërkesën e Ministres të Ministrisë së Drejtësisë.

Po ashtu, sipas shkresës me numër:01-826/2 të datës 19.09.2022 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e ka proceduar kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore tek Kryesuesi i Komisionit Disiplinor, ndërsa Komisioni Disiplinor fillimisht me datë 28.09.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër KD.nr.4/22 përmes të cilit vendim ankuesi është pezulluar përkohësisht nga puna prej datës 28.09.2022 me 50% të pagës. Tutje, me datën 18.10.2022 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, ka nxjerrë Vendimin me numër:01-826/3, sipas të cilit e ka shtyrë afatin fillestar për vendosjen e procedurës disiplinore ndaj ankuesit edhe për tridhjetë (30) ditë, ndërsa pas kësaj me datën 18.11.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër KD.nr.07/2022 sipas së cilit e ka pezulluar tërësisht procedurën disiplinore ndaj ankuesit duke u thirrur në nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 55, 56 dhe 58 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se ndaj tij është hapur rast në Prokurori përkatëse dhe mbi këtë bazë ka vendosur lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore deri në vendosjen e çështjes kryesore nga organi kompetent.



Pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 21.01.2022, Këshilli kishte nxjerr Vendimin A.nr.1233/2022 të datës 20.02.2023, përmes të cilit kishte konstatuar se procedura e ndjekur me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.07/2022 të datës 18.11.2022 nga ana e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së drejtësisë duke lënë në fuqi edhe Vendimin me numër KD.nr.4/22 të datës 28.09.2022, ishte përcjell me shkelje të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj mbi këtë bazë e kishte aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit A.nr.1233/2022 të datës 21.12.2022, ndërsa lëndën e ankuesit e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Komisionin Disiplinor.

Nga shkresat e administruara të lëndës të ofruara me datë 16.05.2023 në cilësi të provave shtesë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë ka nxjerr Vendimin Nr.23/2023 të datës 24.02.2023 përmes të cilit kishte ndryshuar përbërjen apo kishte themeluar Komisionin e ri Disiplinor, ndërsa në pikën 3 të dispozitivit kishte shfuqizuar vendimet paraprake për themelimin e Komisionit Disiplinor, gjegjësisht kishte shfuqizuar Vendimin Nr.32/2022 të datës 03.03.2022, Vendimin Nr.101/2022 të datës 07.09.2022 dhe Vendimin Nr.109/2022 të datës 13.09.2023, mirëpo Vendimit Nr.23/2023 të datës 24.02.2023 i mungon arsyetimi përmes të cilit do të konstatohej fakti nëse janë plotësuar parakushtet ligjore për ndryshimin e përbërjes së Komisionit Disiplinor në frymën e nenit 10 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, apo ka ekzistuar ndonjë rrethanë tjetër ligjore e cila ka mundur të shërbejë si pengesë për vendimmarrje.

Tutje, Komisioni Disiplinor i themeluar sipas Vendimit Nr.23/2023 të nxjerr nga Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm datës 24.02.2023, me qëllim të rishqyrtimit dhe rivendosje së lëndës së ankuesit sipas të gjeturave dhe konstatimeve të dhëna përmes Vendimit të Këshillit A.nr.1233/2022 të datës 20.02.2023, ka mbajtur seancë të rregullt të Komisionit Disiplinor me datë 10.03.2023 dhe po në të njëjtën seancë me datë 10.03.2023 ka nxjerrë Vendimin KD.03/2023 i cili mban numrin e protokollit:01-826/10 të datës 13.03.2023 përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*" e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me arsyetimin se i njëjti ka shkelur dispozitat e nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik sipas gjetjeve të Raportit Hetimor të datës 29.08.2022 të nxjerrë nga Komisioni Hetimor i themeluar në kuadër të Inspektoratit për Inspektimin e Punëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës, që tani e tutje do të referohemi si Komisioni Hetimor.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Disiplinor nuk i kishte ftuar asnjërin nga palët në procedurë në seancën e procedurës disiplinore të mbajtura me datë 10.03.2023, ndërsa Komisioni Disiplinor në provat e shqyrtuara kishte trajtuar edhe dy raporte të cilat nuk ishin pjesë e lëndës në kohën e inicimit të procedurës disiplinore sipas Komisionit Disiplinor, gjegjësisht Raportin e datës 14.11.2016 dhe Raportin e datës 21.11.2016 me numër:01-4435 të hartuara nga ankuesi, të cilat Komisioni Disiplinor i kishte trajtuar në cilësi të provave apo argumenteve kundër ankuesit, mirëpo nuk e kishte par të arsyeshme që palët të ftohen në seancë me arsyetimin se të njëjtit janë ftuar në seancën e kaluar të datës 13.10.2022 dhe se procesverbalet kanë qenë të kompletuara, duke ia falur besimin Raportit të datës 29.08.2022 me numër protokollit:01-826 të hartuar nga Komisioni Hetimor.

Kolegji i Këshillit nga të gjetura e theksuara si më lartë, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes në rastin e lëndës së ankuesi ankuesit, sipas procesverbalit të datës



10.03.2023 pa ftuar në seancë ankuesin, iniciuesin e procedurës disiplinore dhe anëtarët e Komisionit Hetimor të cilit e kishin hartuar raportin e të datës 29.08.2022 me numër protokolli:01-826, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë nenit 12 paragrafi 4 dhe 5 lidhur me mbajtjen e seancave disiplinore ka përcaktuar se: *“Seancat e Komisionit disiplinor janë të mbyllura përpos nëse parashihet ndryshe me Ligjin në fuqi dhe mbahen me praninë fizike të të gjithë anëtarëve siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

**5. Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative”** pasiqë në kuptim të nenit 94 dhe 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes.* 95.1 *Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t’u dëgjuar”,* dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimin KD.nr.03/2023 të datës 13.03.2023 duke mos i ftuar në seancë palët në procedurë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore si dhe në kundërshtim edhe me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *“Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t’u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit”,* pasi që Këshilli përmes Vendimit të A.nr.1233/2022 të datës 20.02.2023 kur ishte shfuqizuar vendimi paraprak të Komisionit Disiplinor KD.nr.07/2022 të datës 18.11.2022 dhe lënda ishte kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje, gjegjësisht rasti ishte kthyer në pikën zero apo deri tek faza kur ishte iniciuar procedura disiplinore nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm, prandaj me rastin që Komisioni Disiplinor është lëshuar në shqyrtim merititor është dashur të veprojë sipas detyrës zyrtare dhe të verifikojë dhe shqyrtojë çdo rrethanë juridike, fakt apo provë relevante dhe të dëgjoj variantin e palëve në procedurë për çështjen e ngritur.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me hartimin e Raportit të datës 29.08.2022 me numër protokolli:01-826 nga Komisioni Hetimor, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nenin 188 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.3 ku përcaktohet se: *“1. Ministria mbikëqyrë zbatimin e dispozitave dhe të punës profesionale të punës së insititucioneve Korrektuese dhe drejtorive rajonale sprovuese me qëllim të sigurimit të sistemit unik të ekzekutimit të sanksioneve penale, bartjen e përvojave, pozitive, analizimit dhe të përcjelljes së punës së disa njësive organizative të institucionit korrektues dhe të ofrimit të ndihmës profesionale atyre njësive; 2. Inspektori bënë mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij Ligji, akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe ka autorizim: 2.1. të hyj në çdo kohë dhe pa paralajmërim në të gjitha hapësirat dhe lokalet e Institucioneve Korrektues dhe drejtorive rajonale sprovuese me qëllim të inspektimit; 2.3. të verifikoj secilin rast veç e veç, çdo herë kur dyshohet për shkelje ligjore. Inspektori inicion procedurën qoftë sipas detyrës zyrtare, apo me iniciativën e personit të interesuar”* dhe ka ardhur në përfundimin se inspektorët e Inspektoratit për Inspektimin e Punës së SHKK-së të cilët e kanë hartuar Raportin e datës 29.08.2022 me numër protokolli:01-826, kanë mandatin ligjor të kujdesen vetëm për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe akteve të tjera nënligjore që rrjedhin prej tij apo hyjnë në kuadër të fushëveprimit të punës në kuadër të SHKK, mirëpo tek rasti i ankuesit të njëjtit kanë dal jashtë mandatit dhe autorizimeve ligjore, ngase në faqen nëntë (9) të Raportit të datës 29.08.2022 kanë konstatuar se ankuesi \_\_\_\_\_ ka kryer shkelje të nenit 8 pika 1 dhe nenit 33 pika 1.5 të Ligjit 06/082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nenit 89 nën paragrafi 1,3.25 dhe 1,3.15 të Kodit



Nr.08/L-032 të Procedurë Penale pasi që i njëjti kanë marrë në posedim incizimin e kamerave të sigurisë papara organeve kompetente të Policisë dhe Prokurorisë, sikurse të njëjtit kanë konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të nenit 427 pika 1 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurë Penale, pasi që ankuesi për rastin kishte hartuar dy raporte kundërthënëse në mes vete (*referuar Raportit datës 21.11.2016 me numër:01-4435 dhe Raportit të datës 14.11.2016*), duke shtuar faktin se ankuesi ka shkelur edhe dispozitat e nenit 45 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 48 pika 5 i të njëjti ligj. Po ashtu në fund të Raportit të datës 28.09.2022 sipas Komisioni Hetimor konstatimet se ankuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore nga ankuesit i kanë mbështetur edhe në dokumentet zyrtare të Policisë së Kosovës lidhur me konfiskimin e USB-ve nga zyrtarët e lartcekur që dëshmon se ende nuk ka përfunduar rasti i hetimeve.

Nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit konstatimet e dhëna nga Komisioni Hetimor në Raportin e datës 28.09.2022 me numër:01-826 ku ishte konstatuar se ankuesi ka shkelur dispozitat e Ligjit 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2019, Kodit Nr.08/L-032 të Procedurë Penale dhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2020, janë konstatime të cilat dalin përtej autorizimeve ligjore të Komisionit Hetimor në kuadër të Inspektoratit për Inspektimin e Punës së SHKK, pasi që lidhur me konstatimin e shkeljeve të dispozitave të Ligjit 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale autoriteti përgjegjës sipas këtij ligji është Agjencia për Informim dhe Privatësi, për konstatimin e shkeljeve të dispozitave të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale dhe shqiptimin e masës apo dënimit për klasifikimin e përcaktuar të shkeljes nga ankuesi bëhet nga autoriteti gjyqësor-Gjykata Kompetente nën kushtet dhe procedurat e përcaktuara të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale, ndërsa për konstatimin e shkeljeve të dispozitave Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është Komisioni Disiplinor në kuadër të institucionit, kurse vendimet e Komisionit Disiplinor përmes procesit të ankimimit i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, prandaj mbi këtë bazë ne mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme"*, prandaj nisur nga ky fakt bazik dhe i pakontestueshëm, konstatohet fakti se Raporti i datës 28.09.2022 me numër:01-826 është akt administrativ i paligjshëm.

Po ashtu, ndërlidhur me veprimin e Komisionit Disiplinor i cili kishte mbajtur seancën e datës 10.03.2023 dhe kishte nxjerr aktin sipas të cilit ankuesi është shpallur përgjegjës duke mos ftuar palët në procedurë, duke mos shqyrtuar dhe analizuar në procedurë administrative asnjë konstatim të dhanë nga Komisioni Hetimor, janë veprime që bien ndesh me dispozitat e dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku shprehimisht rregullohet se: *"1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 3. Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes"* ngase sipas detyrës zyrtare Komisioni Disiplinor ka qenë i obliguar të ftojë në seancë ankuesin, iniciuesin e procedurës disiplinore dhe të tre (3) anëtarët e Komisionit Hetimor të cilët e kishin hartuar Raportin e datës 29.08.2022 për të njohur me variantin e tyre të ngjarjes,



mirëpo Komisioni Disiplinor ia ka falur besimin një raporti të nxjerrë nga Komisioni Hetimor i cili ka tejkaluar autorizimet ligjore, gjegjësisht të njëjtën kohë ka ushtruar detyrat dhe kompetencat e tre (3) institucioneve të tjera të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit Nr.03/2023 të datës 13.03.2023 ka shkelur dispozitat e nenit 48 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate”* si dhe nenin 10 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë përcaktohet se: *“Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative”* nga rrjedh se në rastin konkret Komisioni Disiplinor ka shkelur në mënyrë flagrante dispozitat e lartcekura ligjore të Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës fillestare të datës 21.12.2022, ka sjellë në cilësi të provave materiale Vërtetimin e datës 12.12.2022 i orës 09:51 me numër reference: RN-202-CF-6463 përmes të cilit ankuesi dëshmon se i njëjti nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës, dhe Çertifikatën me shifër PN.NR/1007222 të datës 30.11.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj përmes të cilës dëshmohet se ankuesi nuk është i dënuar dhe ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale, dhe që të dyja shkresat janë administruara dhe përdorur në arsyetimin e Vendimit A.nr.1233/2022 të datës 20.02.2022 nga ana e Këshillit, ndërsa Komisioni Disiplinor nuk iu kishte kushtuar vëmendje në pikëpamje juridike të shkresave materiale, e të cilat e dëshmojnë të kundërtën e Raportit Hetimor të datës 29.08.2022 të hartuar nga Komisioni Hetimor i Inspektoratit për Inspektimin e Punës së SHKK-së.

Kolegji i Këshillit po ashtu sjell në vëmendje se Ligji Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020 dhe si rrjedhojë i njëjti ligj nuk ka efekt prapaveprues, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor nuk mund ta gjejë përgjegjës ankuesin për shkeljen e dispozitave të nenit 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë për vitin 2016, gjegjësisht për kohën sa i njëjti ligj nuk ka qenë në fuqi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes së lëndës së ankuesit kanë zbatuar gabimisht pikëpamjet e vendimit të Këshillit, ngase në arsyetimin e Vendimit A.nr.1233/2022 të datës 20.02.2023 me rastin e kthimit të lëndës së ankuesit në rishqyrtim kishte konstatuar se Komisioni Disiplinor asaj kohe me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.07/2022 të datës 18.11.2022 lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore për rastin e ankuesit, nuk kishte vepruar në mënyrë të drejtë dhe kishte zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, ngase përveçse e ka pezulluar procedurën disiplinore të iniciuar sipas kërkesës së datës së datës 19.09.2022 e ka lënë në fuqi edhe vendimin paraprak të datës 28.09.2022 më numër KD.nr.4/2022 për pezullim të përkohshëm të ankuesit nga puna me kompensimin prej 50% të pagës, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor ka mundur ta pezullojë shqyrtimin e procedurës së iniciuar disiplinor, mirëpo është dashur që ta shfuqizojë vendimin paraprak të datës 28.09.2022 më numër KD.nr.4/2022 për



pezullim të përkohshëm të ankuesit nga puna me kompensimin prej 50% të pagës, dhe më pastaj pas shqyrtimit eventual të rastit në instanca gjyqësore dhe pasi që vendimi përfundimtar të marrë formën e prerë në procedurë gjyqësore, Komisioni Disiplinor ka mundur të aktivizojë lëndën dhe më pastaj mbi bazën e konstatimeve eventuale të shkeljeve të detyrave të punës apo legjislacionit në fuqi nga ankuesi t'i shqiptojë edhe masën disiplinore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se Ministria e Drejtësisë me rastin e sjelljes së provave përmes shkresës së datës 20.01.2023 me numër protokolli:593/2023 lidhur me vendosjen e lëndës A.nr.1233/2022 të datës 21.12.2022 dhe as përmes shkresës së datës 16.05.2023 me shifër protokolli:01-826 lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.638/2023 të datës 14.04.2023 nuk kanë ofruar dëshmi se ndaj ankuesit apo lidhur me veprimet apo mos veprimet e tij për kohën sa është gjetur përgjegjës të është përcjellë ndonjë shkresë në instancat tjera të ndjekjes apo gjykimit për shkelje përveç e-mailit të datës 11.10.2022 të dërguar nga shefi i kabinetit të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë për kryetarin e Komisionit Disiplinor i cili shprehet se raporti (në vlerësimin e Kolegjit lënë të kuptohet për raportin e datës 29.08.2022) është përcjellë në zyrën e prokurorit të Shtetit, ndërsa të njëjtin për shkak të kompetencës e kanë përcjellë në Prokurorinë Speciale. Mirëpo, Këshilli nga shqyrtimi i ankesës me shifër A.nr.547/2023 e cila për objekt shqyrtimi ka edhe Raportin e datës 29.08.2022 në shkresat e lëndës ka gjetur se Prokurori i Shtetit përmes Shkresës PPN.nr.273/22 të datës 13.09.2022 e ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë se për shkak të kompetencës dhe se të gjitha shkresat e lëndës që ndërlidhën me rastin e Qendrës së Paraburgimit në Prizren lidhur me rastin kanë përcjellë tek Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, andaj kjo provë në rastin konkret paraqet rrethanë të re juridike të cilën Komisioni Disiplinor nuk e ka trajtuar me rastin e pezullimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit sipas Vendimit me numër KD.nr.07/2022 të datës 18.11.2022.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se procedura e ndjekur nga ana e Komisionit Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit KD.nr.03/2023 të datës 13.03.2023 përmes të cilit akt, ankuesit i është masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" është përcjellë me shkelje procedurale, gjegjësisht është përcjellë me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, prandaj si i tillë është akt i paligjshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe mbi këtë bazë Vendimi KD.nr.03/2023 i datës 13.03.2023 i Komisionit Disiplinor është shfuqizuar si në diapozitiv të këtij vendimi, pasi që një akt i tillë administrativ nuk ka mundur të përliqet për shkak të shkeljeve procedurale.

Mirëpo, nga se u tha si më lartë, meqenëse sipas Shkresës PPN.nr.273/22 së Prokurorit të Shtetit përmes Shkresës të datës 13.09.2022, përmes të cilës konfirmohet se rasti është bartur në Prokurorinë Speciale për shkak të kompetencës, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor mundet që të nxjerrë akt dhe ta pezullojë procedurën disiplinore të iniciuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm përmes shkresës së datës 19.09.2022, ndërsa pas shqyrtimit të rastit nga institucionet përgjegjëse, gjegjësisht Gjykatat kompetente dhe dhënies së verdiktit final, atëherë Komisioni Disiplinor mundet ta aktivizojë lëndën duke e liruar nga përgjegjësia apo duke i shqiptuar masën disiplinore ankuesit varësisht nga lloji i vendimit përfundimtar. Po ashtu, Kolegji Këshillit thekson faktin se mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nëse gjyqtari i çështjes vendos masë të pezullimit parandalues lidhur me ushtrimin e funksionit publik ndaj ankuesit, në këtë rast institucioni punëdhënës mund ta pezullojë nga puna ankuesin deri në zgjidhjen e çështjes kryesore.



Kolegji i Këshillit, po ashtu ka konstatuar se institucionin punëdhënës e ka bërë ekzekutimin e Vendimit KD.nr.03/2023 i datës 13.03.2023 të Komisionit Disiplinor, duke ia ndalur ankuesit pagën, veprim ky i cili bie ndesh me nenin 144 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "1 Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar", mirëpo në rastin konkret ankuesi ka pasur të parashtruar ankesë në këshill për të cilën ka qenë në dijeni edhe Ministria e Drejtësisë, andaj në mbështetje të nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Përveçse kur parashkohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën" institucioni nuk është dashur ta ekzekutojë vendimin e goditur përmes kësaj ankesë, dhe mbi këtë bazë sikurse edhe mbi bazën e të lartcekurave si më lartë ankuesit me rastin e kthimit në vendin e punës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, obligohet që të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim që ankuesit t'i bëhet kompensimi në mënyrë retroaktive i ndaljes së 50% nga momenti ndaljes së pagës sipas Vendimit me numër KD.nr.4/22 i datës 28.09.2022, ndërsa kompensimin e pagës së plotë ta bëjnë nga momenti i ndaljes së saj sipas Vendimit KD.nr.03/2023 i datës 13.03.2023.

Keshtu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër **A.nr.638/2023**

**Flakron GASHI**

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.